



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Beledijesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 477/25 Dt. 01.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Memorandumit të Bashkëpunimit (bashkëfinancimit) mes Swisscontact-it, Komunës së Prizrenit, dhe OJQ “Makerspace-Innovation Center Prizren” (MICP), 01 Nr. 451/25, të datës 25.07.2025, të nenit 3 paragrafi 4 dhe nenit 14 paragrafi 1.4 Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejin e mjeteve për bashkëfinancim të projektit

1. Lejohen mjetet financiare për bashkëfinancim në realizimin (financimin) e projektit që ka të bëjë me zhvillimin e aftësive të avancuara dhe përmirësimit të punësueshmërisë përmes zbatimit të programit të specializuar të trajnimit në fushën e Shkencave të Dhënave (Data Science), i cili bashkëfinancim është i bazuar në nenin 2 dhe aneksit 1 të Memorandumit të Bashkëpunimit (bashkëfinancimit) mes Swisscontact-it, Komunës së Prizrenit dhe OJQ “Makerspace-Innovation Center Prizren” (MICP), 01 Nr. 451/25, të datës 25.07.2025, kështu që, për këtë qëllim Komuna e Prizrenit, në emër të bashkëfinancimit për këtë projekt, lejon mjetet financiare si në vijim:
2. Për licencimin e programit, lejon mjetet financiare në shumën 10.000,00 €,.
- 2.1. Për Programin/Aktivitetin 1, lejon mjetet financiare në shumën 15.500,00 €,
- 2.2. Për Programin/Aktivitetin 2, lejon mjetet financiare në shumën 9.500,00 €,
- 2.3. Për Programin/Aktivitetin 3, lejon mjetet financiare në shumën 2.100,00 €,
- 2.4. Për Programin/Aktivitetin 4, lejon mjetet financiare në shumën 3.650,00 €,
- 2.5. Për Programin/Aktivitetin 5, lejon mjetet financiare në shumën 4.450,00 €,
- 2.6. Për Programin/Aktivitetin 6, lejon mjetet financiare në shumën 24.000,00 €,
- 2.7. Për Programin/Aktivitetin 7, lejon mjetet financiare në shumën 4.000,00 €,
- 2.8. Për Programin/Aktivitetin 8, lejon mjetet financiare në shumën 1.100,00 €,
- 2.9. Për Programin/Aktivitetin 9, lejon mjetet financiare në shumën 5.500,00 €,
- 2.10. Për Programin/Aktivitetin 10, lejon mjetet financiare në shumën 10.700,00 €,
- 2.11. Për Programin/Aktivitetin 11, lejon mjetet financiare në shumën 4.000,00 €,
- 2.12. Për Programin/Aktivitetin 12, lejon mjetet financiare në shumën 4.000,00 €.

3. Shuma e përgjithshme që lejohet është 98.500.00 € (nëntëdhjetë e tetëmijë e pesëqind euro).
4. Mjetet e lartcekura, si në këtë Vendim, do të alokohen në xhirollogarinë e Swisscontact-it.
5. Zyrtar përgjegjës për të mbikëqyrur projektin, nga Komuna e Prizrenit, caktohet z. Halil Lika.
6. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Memorandumi i Bashkëpunimit (bashkëfinancimit) mes Swisscontact-it, Komunës së Prizrenit dhe OJQ "Makerspace-Innovation Center Prizren" (MICP), 01 01 Nr. 451/25, të datës 25.07.2025.
7. Shuma e lejuar, me këtë Vendim, do të sigurohet nga buxheti i Komunës—pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime të Komunës së Prizrenit.
8. Obligohet Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave dhe zyrtari përgjegjës për mbikëqyrje të projektit për zbatimin e vendimit.
9. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Swisscontact-it,
 - Makerspace Innovation Center,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.